

VENDIM
Nr.684, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA SHIRGJAN, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shirgjan të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Shirgjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna: Shërgjjan										
Nr.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni, për të cilin përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	709	EP Shpat - Shtërmën	Shkëmbi i Mjekesit	27/b	Pyll	2.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Elbasan	
2	710	EP Shpat - Shtërmën	Reparti	27/c	Pyll	1.60	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Elbasan	
3	712	EP Shpat - Shtërmën	Dushku i Kryezj.	85/a	Pyll	12.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Elbasan	
4	713	EP Shpat - Shtërmën	Dushku i Kryezj.	85/b	Djerr	5.50		M.M.P.A.U.	D.SH.P. Elbasan	
5	715	EP Shpat - Shtërmën	Topcias	86	Djerr	5.50		M.M.P.A.U.	D.SH.P. Elbasan	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Shirgjan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
709 - 710; 712 - 713; 715	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi